



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 12.11.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas ankesës të datës 09.11.2018 të parashtruar nga grupi i Operatoreve Ekonomik "MatkosPharm" për aktivitetin :"**Furnizimi me paisje mjekësore për QKMF dhe QMU-lot 5**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-5536-111 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "MatkosPharm" e datës 09.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Furnizimi me paisje mjekësore për QKMF dhe QMU-lot 5**", me Nr.616 18 5536 111 Nr. Brendshëm 616 18 090 111 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së dhe Refuzimin e tenderit të pretenduesit për lot 5, dërguar me datën 01.11.2018 dhe publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 01.11.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "MatkosPharm" me datë 09.11.2018 ka parashtruar ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"**Furnizimi me paisje mjekësore për QKMF dhe QMU-lot 5**".

Autoriteti Kontraktues, me datë 12.11.2018, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi pas pranimit të Njoftimit për refuzimin e tenderit të tij për lot 5 ka shprehur mospajtimin e tij dhe ka kërkuar sqarime lidhur me këtë, edhe pse i ka pasë të qarta arsyet e eliminimit dhe sipas të njejtit Njoftim e ka pasë të shkruar qartë se nëse beson se AK-ja ka shkelur LPP-ik gjatë zhvillimit të procedurave mund të bëjë ankesë në bazë të nenit 108/A të

LPP-ik, respektivisht se ka të drejtë të parashtroj ankesë pranë Autoritetit Kontraktues. Sipas dispozitave ligjore në fuqi tenderuesi i pakënaqur duhet të dorëzoj Kërkesën për rishqyrtim nëpër mes formularit standad F02 të aprovuar nga KRPP-ja dhe atë në afatin prej pesë(5)ditëve nga dita e publikimit të Njoftimit për vendimin e Autoritetit Kontraktues. Pretenduesi nuk ka zbatuar as përdorimin e formularit standard për ankesë e as afatin e paraparë në dispozitat ligjore, prandaj AK-ja ka vazhduar me procedurë, ka bërë publikimin e Njoftimit për dhënje të kontratës dhe janë nënshkruar kontratat. Poashtu për korektësi duhet sqaruar se edhe sikur të ishte ankesa e dërguar brenda afatit pretendimet do të ishin të pa bazuara për dy arsye: e para është kërkuar pesha maksimum katër(4) kilogram që e përjashton pranimin e çdo oferte mbi atë peshë për atë artikull dhe e dyta ndryshimi i artikullit që ju e propozoni është i paligjshëm dhe paraqet shmangje materiale nga tenderi i dorëzuar. Bazuar në faktin se pretenduesi nuk ka respektuar afatet ligjore për parashtrim dhe dorëzim të kërkesës për rishqyrtim u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit